

Vendim nr. 301 datë 17.12.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 17.12.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 43 (A) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ANDRI LEKA**, përfaqësuar nga avokati Eno Seferi, me akt-përfaqësimi.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 682/13-2023-2963 datë 28.09.2023; nr. 687/13-2023-2988, datë 02.10.2023; nr. 700/13-2023-3017, datë 05.10.2023; nr. 704/13-2023-3029, datë 07.10.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan; nr.2032/30-2023-6296, datë 06.11.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2024-581, datë 04.04.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Kthimi për rigjykim pranë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

BAZA LIGJORE: **Nenet 33, 34, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 2 dhe 71/a të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të**

Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Andri Leka është proceduar penalisht pas kallëzimeve të bëra nga shtetasit B.K., E.K. dhe A.K., procedime të cilat në një moment janë bashkuar, më pas janë ndarë, ndërsa në vijim disa prej tyre janë bashkuar përsëri. Në secilin nga procedimet penale ndaj kërkuesit është caktuar masa e sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në burg”. Për këtë masë sigurimi, në një nga procedimet penale (të bashkuara), kërkuesi i ka kërkuar gjykatës (gjyqtarit të seancës paraprake), në katër raste, shuarjen e saj, ndërsa në vijim ai ka kundërshtuar vendimet e gjykatave të zakonshme përmes ankimit kushtetues individual. Nisur nga kjo, është i nevojshëm përshkrimi i të dhënave për secilin procedim penal dhe masë sigurimi të caktuar ndaj kërkuesit.

Procedimi i parë penal

2. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*Prokuroria e Tiranës*), mbi kallëzimin penal të shtetases B.K., në datën 21.07.2021 ka regjistruar procedimin penal nr. 5233, viti 2021, në ngarkim të kërkuesit Andri Leka, për veprat penale “Shpifja”, “Përndjekja”, “Falsifikimi i dokumenteve” më shumë se një herë dhe “Fyerja e gjyqtarit”, të parashikuara nga nenet 120, 121/a, 186, paragrafi 2 dhe 318 të Kodit Penal (*KP*).

3. Në kuadër të këtij procedimi penal kërkuesi është ndaluar nga Policia Gjyqësore në datën 22.07.2021 dhe në vijim, mbi kërkesën e prokurorit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1262 akti, datë 22.07.2021, ka vleftësuar të ligjshëm ndalimin dhe ka vendosur ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal “Arresti në burg”. Ky vendim, pas ankimimit nga kërkuesi, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 693, datë 10.08.2021.

4. Ky procedim penal në vijim është bashkuar me një tjetër procedim penal të filluar më pas ndaj kërkuesit, por që më vonë janë ndarë, duke vijuar secili në mënyrë të pavarur, ndërsa pjesë e këtij procedimi është bërë edhe një kallëzim tjetër i shtetases B.K. për veprën penale

“Shtrengimi me ane te kanosjes ose dhunes per dhënien e pasurisë”, te parashikuar nga neni 109/b, paragrafi 1, i KP-së.

5. Pas përfundimit të hetimeve paraprake të këtij procedimi penal, çështja është dërguar për gjykim, në përfundim të të cilit, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1569, datë 16.06.2023, ka vendosur të deklarojë fajtor kërkuesin për veprën penale “Përndjekja”, të parashikuar nga neni 121/a, paragrafi 1, i KP-së, duke e dënuar atë me 3 vjet e 3 muaj burgim, ndërsa vuajtja e dënimit fillon nga dita e ndalimit, data 22.07.2021. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim, mbi bazën e të cilit çështja është regjistruar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Ndërsa çështja ka qenë në pritje për t’u gjykuar, mbi kërkesën e kërkuesit, ajo gjykatë apeli, me vendimin nr. 1646 (30-2023-5102), datë 23.09.2023, ka vendosur deklarinimin e shuarjes së masës së sigurimit “Arresti në burg”, caktuar ndaj tij me vendimin nr. 1262 akti, datë 25.07.2021 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për shkak se kohëzgjatja e paraburgimit e vuajtur nga ai nën këtë masë është më e madhe se sa masa e dënimit me burgim të caktuar për të me vendimin nr. 1569, datë 16.06.2023 të asaj gjykate. Në këtë rast, gjykata e apelit ka urdhëruar edhe lirimin e menjëhershëm nga paraburgimi të kërkuesit nëse nuk mbahej për ndonjë masë tjetër sigurimi personal “Arresti në burg” ose vendim penal dënimi.

Procedimi i dytë penal

6. Shtetasi E.K., bashkëshort i kallëzueses B.K., ka paraqitur një kallëzim penal përpara Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), kallëzim i cili drejtohej edhe kundër kërkuesit, për veprat penale “Përndjekja” dhe “Shtrengimi me ane te kanosjes ose dhunes per dhënien e pasukrisë”, të parashikuara nga nenet 121/a dhe 109/b, paragrafi 1, të KP-së. Me shkresën nr. 606, datë 30.07.2021, materialin kallëzues në lidhje me kërkuesin Prokuroria e Posaçme ia ka përcjell për kompetencë Prokurorisë së Tiranës. Sipas këtij materiali, ndër të tjera, referohet se ndaj kallëzuesit E.K. dhe familjes së tij po konsumohej nga një grup bashkëpunëtorësh vepra penale “Shtrengimi me ane te kanosjes ose dhunes per dhënien e pasurisë”.

7. Në vijim, shtetasja B.K. ka paraqitur përpara Prokurorisë së Tiranës një kallëzim tjetër penal ndaj kërkuesit për veprën penale “Shtrengimi me ane te kanosjes ose dhunes per dhënien e pasurisë”, të parashikuar nga neni 109/b, paragrafi 1, i KP-së. Materiali kallëzues është bashkuar me atë të përcjellë nga Prokuroria e Posaçme, ndërsa përmbajtja e tyre ka qenë e njëjtë. Po ashtu, në atë prokurori ka paraqitur kallëzim penal ndaj kërkuesit edhe shtetasja A.K., motra e kallëzuesit

E.K., po për të njëjtat vepra penale. Edhe ky material kallëzues është bashkuar me materialet e tjera kallëzuese.

8. Mbi këto materiale, Prokuroria e Tiranës në vijim ka regjistruar ndaj kërkuesit procedimin penal nr. 5649, viti 2021, për veprat penale “Përndjekja” dhe “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, të parashikuara nga nenet 121/a dhe 109/b, paragrafi 1, të KP-së. Ky procedim penal fillimisht është bashkuar me procedimin penal të regjistruar më parë (nr. 5233, viti 2021) dhe në vijim, në datën 19.01.2022, procedimi penal është ndarë në tre të tillë sipas kallëzuesve respektivë dhe konkretisht: procedimi penal nr. 5649, viti 2021, me kallëzuese B.K.; procedimi penal nr. 5649/1, viti 2021, me kallëzues E.K. dhe procedimi penal nr. 5649/2, viti 2021, me kallëzuese A.K.

Procedimi i dytë penal (pas ndarjes)

9. Në kuadër të procedimit penal nr. 5649/1, viti 2021, me kallëzues E.K., mbi kërkesën e prokurorit, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 184/1 akti, datë 26.01.2022, ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit “Arresti në burg”, ndërsa me vendimin nr. 184/3 akti, datë 23.02.2022, ka vendosur vazhdimin e zbatimit të kësaj mase sigurimi, si dhe shpalljen e moskompetencës së saj dhe kalimin e akteve të këtij procedimi penal Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, ndërsa Prokuroria e Tiranës kishte shpallur moskompetencën e saj lëndore duke ia dërguar aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës (*Prokuroria e Durrësit*). Ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar.

10. Aktet e këtij procedimi penal Prokuroria e Tiranës ia ka kaluar për kompetencë Prokurorisë së Durrësit dhe, në vijim, mbi kërkesën e prokurorit, Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. (11-2022-1599) 217, datë 04.04.2022, ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit “Arresti në burg”. Ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar.

11. Më pas, aktet e këtij procedimi penal Prokuroria e Durrësit ia ka kaluar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan (*Prokuroria e Elbasanit*), e cila, në datën 07.04.2022 ka regjistruar ndaj kërkuesit procedimin penal nr. 811, viti 2022, për veprat penale “Përndjekja” dhe “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, të parashikuara nga nenet 121/a dhe 109/b, paragrafi 1, të KP-së.

12. Në vijim, mbi kërkesën e prokurorit, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan, me vendimin nr. 398 (13-2022-2767), datë 24.05.2022, ka rivlerësuar masën e sigurimit ndaj kërkuesit, duke i

caktuar masën “Arresti në burg”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. (10-2022-1023)216, datë 14.06.2023.

Procedimi i tretë penal (pas ndarjes)

13. Në kuadër të procedimit penal nr. 5649/2, viti 2021, me kallëzuese A.K., mbi kërkesën e prokurorit, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 184/2 akti, datë 26.01.2022, ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit “Arresti në burg”, ndërsa me vendimin nr. 184/4 akti, datë 23.02.2022 ka vendosur vazhdimin e zbatimit të kësaj mase sigurimi, si dhe shpalljen e moskompetencës së saj dhe kalimin e akteve të këtij procedimi penal Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ndërsa Prokuroria e Tiranës ka shpallur moskompetencën e saj lëndore duke ia dërguar aktet Prokurorisë së Elbasanit. Ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar.

14. Aktet e këtij procedimi penal Prokuroria e Tiranës ia ka kaluar për kompetencë Prokurorisë së Elbasanit, e cila, në datën 04.03.2022 ka regjistruar ndaj kërkuesit procedimin penal nr. 320, viti 2022, për veprat penale “Përndjekja” dhe “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, të parashikuara nga nenet 121/a dhe 109/b, paragrafi 1, të KP-së.

15. Në vijim, mbi kërkesën e prokurorit, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan, me vendimin nr. 204 (13-2022-1188), datë 08.03.2022, ka rivlerësuar masën e sigurimit ndaj kërkuesit duke i caktuar masën “Arresti në burg”. Ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar. Po ashtu, me vendimin nr. 276 (13-2022-1823), datë 07.04.2022, ajo gjykatë ka rivlerësuar sërish masën e sigurimit “Arresti në burg” ndaj kërkuesit. Edhe ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar.

Bashkimi i procedimeve dhe seanca paraprake

16. Me vendimin e datës 13.06.2022, Prokuroria e Elbasanit ka bashkuar në një të vetëm të dyja procedimet penale të regjistruara nga ajo ndaj kërkuesit, ato me kallëzues E.K. dhe A.K. Në përfundim të hetimeve paraprake të këtij procedimi penal, në datën 25.11.2022 ajo prokurori i është drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin në gjyq të çështjes në ngarkim të kërkuesit në lidhje me akuzën për veprën penale “Përndjekja”, të parashikuar nga neni 121/a i KP-së (dy herë), si dhe pushimin e hetimeve ndaj tij për veprën penale “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, të parashikuar nga neni 109/b, paragrafi 1, i KP-së.

17. Me vendimin nr. 2253, datë 06.02.2023, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan (gjyqtari i seancës paraprake) ka vendosur kthimin e akteve prokurorit për plotësimin e hetimeve, duke i caktuar si afat datën 08.03.2023. Pas plotësimit të hetimeve, Prokuroria e Elbasanit ka paraqitur

përsëri kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq dhe pushimin e hetimeve. Edhe në këtë rast, me vendimin nr. 2253, datë 05.05.2023, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan ka vendosur kthimin e akteve prokurorit për plotësimin e hetimeve brenda një afati 2-mujor.

18. Në datën 06.09.2023 Prokuroria e Elbasanit ka paraqitur përsëri kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq për veprën penale “Përndjekja” (dy herë) dhe pushimin e hetimeve për veprën penale “Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”.

Kërkesat për shuarjen e masës së sigurimit

19. Gjatë zhvillimit të seancës paraprake, në datën 26.09.2023 kërkuesi ka paraqitur kërkesë për shuarjen e masës së sigurimit “Arresti në burg”, të caktuar me vendimet e sipërpërmendura të gjykatave të shkallës së parë Tiranë, Durrës dhe Elbasan, me pretendimin se paraburgimi ka humbur fuqinë për shkak të kalimit të kohëzgjatjes tërësore të tij referuar nenit 264, paragrafi 3, të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ndërsa kishte kaluar më shumë se gjysma e afatit maksimal të dënimit të parashikuar për veprën penale “Përndjekja”, për të cilin është proceduar. Me vendimin nr. 682 (13-2023-2963), datë 28.09.2023, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim.

20. Në datën 29.09.2023 kërkuesi ka paraqitur sërish përpara gjyqtarit të seancës paraprake një kërkesë për shuarjen e masës së sigurimit “Arresti në burg”, me pretendimin se paraburgimi ka humbur fuqinë për shkak se nga fillimi i zbatimit të tij kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj pa u dorëzuar aktet në gjykatë, referuar nenit 263, paragrafi 1, shkronja “b”, të KPP-së. Me vendimin nr. 687 (13-2023-2988), datë 02.10.2023, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan ka vendosur sërish rrëzimin e kërkesës. Edhe kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim.

21. Po ashtu, në datën 04.10.2023 kërkuesi ka paraqitur sërish përpara gjyqtarit të seancës paraprake një kërkesë për shuarjen e masës së sigurimit “Arresti në burg”, me pretendimin se për sa kohë që gjatë hetimeve paraprake prokurori nuk ka kërkuar zgjatjen e afateve të paraburgimit, paraburgimi ndaj tij ka humbur fuqinë sipas nenit 263, paragrafi 1, shkronja “b”, të KPP-së. Me vendimin nr. 700 (13-2023-3017), datë 05.10.2023, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan ka vendosur sërish rrëzimin e kërkesës. Edhe kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim.

22. Gjithashtu, në datën 05.10.2023 kërkuesi ka paraqitur sërish përpara gjyqtarit të seancës paraprake një kërkesë për shuarjen e masës së sigurimit “Arresti në burg”, me pretendimin se paraburgimi ndaj tij ka humbur fuqinë sipas nenit 263, paragrafi 1, shkronja “b”, të KPP-së. Me

vendimin nr. 700 (13-2023-3017), datë 05.10.2023, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan ka vendosur sërish rrëzimin e kërkesës. Edhe kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim.

23. Ankimet si më lart të kërkuetit janë bashkuar, duke u shqyrtuar në një proces të vetëm nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila, me vendimin nr. 2032 (30-2023-6296), datë 06.11.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimeve përkatëse të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs.

24. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-581, datë 04.04.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuetit, me arsyetimin se në të nuk ngrihen shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 289, pika 8, të lidhur me nenin 432 të KPP-së.

25. Në datën 11.10.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuetit

26. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi:

26.1. Gjykatat nuk kanë evidentuar veprimet në kundërshtim me ligjin të organit të ndjekjes penale në lidhje me bashkimin e procedimeve penale, në shkelje të nenit 79 të KPP-së, pasi kërkuesi ka qenë në cilësinë e personit nën hetim dhe jo të pandehurit për ndonjë vepër penale. Ky veprim, sikundër edhe shpallja e moskompetencës lëndore, kanë rënduar në mënyrë ekstreme pozicionin e tij në procesin penal.

26.2. Gjykata e shkallës së parë ka zbatuar keq ligjin kur arsyeton se masat e sigurimit për të cilat është kërkuar shuarja janë caktuar më vonë dhe efektet e tyre kanë filluar kur kanë mbaruar efektet e masës së parë, duke iu referuar për këtë vendimit nr. 00-2023-435, datë 13.03.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili nuk është vendim njësuës dhe, për më tepër, kur rasti i kërkuetit është i ndryshëm, pasi ai nuk ka kryer ndonjë vepër penale gjatë kohës së qëndrimit në paraburgim sipas masës së parë. Gjykata e apelit nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuetit në këtë drejtim.

26.3. Gjykatat kanë zbatuar keq ligjin, pasi nuk kanë marrë parasysh se masat e sigurimit për të cilat është kërkuar shuarja, në përmbushje të nenit 250 të KPP-së, i janë

komunikuar kërkuesit në datën 22.02.2022, ditë nga e cila, sipas kësaj dispozite, kanë filluar edhe efektet e tyre. Për rrjedhojë, paraburgimi ndaj kërkuesit ka humbur fuqinë për shkak të kalimit të kohëzgjatjes tërësore të tij referuar nenit 264, paragrafi 3, të KPP-së, ndërsa kishte kaluar më shumë se gjysma e afatit maksimal të dënimit të parashikuar për veprën penale “Përndjekja”, për të cilën është proceduar. Po ashtu, paraburgimi ka humbur fuqinë edhe për shkak se nga fillimi i zbatimit të tij, data 22.02.2022, kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj pa u dorëzuar aktet në gjykatë, referuar nenit 263, paragrafi 1, shkronja “b”, të KPP-së.

- 26.4. Gjykatat e faktit kanë shkelur nenin 261, paragrafi 3, në lidhje me nenin 248, paragrafi 2, të KPP-së, ndërsa vendimet e arsyetuara i kanë depozituar përtej afatit prej 48 orësh. Kështu, vendimi i gjykatës së shkallës së parë i datës 28.09.2023 i është njoftuar kërkuesit në datën 13.10.2023, ndërsa vendimet e saj të datave 02.10.2023, 05.10.2023 dhe 07.10.2023 i janë komunikuar atij në datën 18.10.2023. Po ashtu, vendimi i gjykatës së apelit është arsyetuar pas më shumë se dy muajve.
- 26.5. Gjykata e apelit ka zbatuar keq ligjin kur ka bashkuar ankimet e kërkuesit në një gjykim të vetëm, megjithëse ato lidheshin me kërkesa që mbështeteshin në dispozita të ndryshme ligjore, ndaj për shkak të këtij bashkimi, kërkuesi nuk ka marrë përgjigje për pretendimet e ngritura në secilin ankim. Po ashtu, ajo gjykatë nuk ka respektuar nenin 261, paragrafi 3, të KPP-së, ndërsa nuk i ka shqyrtuar ankimet e kërkuesit brenda afatit prej 48 orësh. Gjithashtu, ajo gjykatë ka vepruar në kundërshtim me nenin 14 të KPP-së, ndërsa ka shqyrtuar çështjen me trup gjykues të formuar nga një gjyqtar.
- 26.6. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekursin e kërkuesit, ndërsa në të janë parashtruar çështje që kishin nevojë për njësim të praktikës gjyqësore në lidhje me momentin kur fillon efektet masa e arrestit në burg në rastin kur personi ka qenë nën efektet e një mase të mëparshme.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

27. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

28. Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar në përfundim të të cilit është vendosur për vijimin e kufizimit të lirisë personale, për shkak të masës së sigurimit personal të arrestit në burg, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

29. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me funksionin subsidiar të mbrojtjes kushtetuese, që mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor. Megjithatë, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendime gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg, duke arsyetuar se karakteri i këtij vendimi, që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, e bën atë një vendim përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 17, datë 13.03.2024; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuesi kundërshton vendimet e dhëna nga të tria gjykatat e zakonshme, të cilat nuk kanë pranuar kërkesat e tij për shuarjen e masës së sigurimit “Arresti në burg”, duke konfirmuar kështu praktikisht vijimin e qëndrimit të tij në paraburgim, ndaj në këto rrethana kërkuesi nuk ka mjet tjetër ankimi në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ai e ka përmbushur edhe këtë kriter të legjitimitetit.

31. Lidhur me legjitimitetin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit

kushtetues individual. Gjykata e ka llogaritur afatin 4-mujor duke filluar nga data e shpalljes së vendimit nga gjykata që ka përfunduar procesin gjyqësor, pra nga organi gjyqësor që përbën mjetin e fundit ankimor. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet ajo datë kur vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi më i fundit gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi është ai i dhënë nga Gjykata e Lartë në datën 04.04.2024, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 11.10.2024. Nga komunikimi shkresor i datës 26.06.2024 ndërmjet përfaqësuesit të kërkuesit dhe Gjykatës së Lartë, rezulton se kjo e fundit ka bërë njoftimin elektronik të vendimit të saj në adresën elektronike të përfaqësuesit të kërkuesit në datën 13.06.2024. Për rrjedhojë, ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor, ndaj kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

33. Për sa i përket legjitimitit *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, por pa identifikuar ndonjë aspekt konkret të kësaj të drejtë. Megjithatë, bazuar në parimin *jura novit curia*, referuar disa prej argumenteve të parashtruara nga kërkuesi, pretendimet e tij kanë të bëjnë me të drejtën për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj, të drejtën e aksesit dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Ndërsa për sa u përket pretendimeve në lidhje me zbatimin e ligjit procedural për bashkimin e procedimeve penale, shpalljen e moskompetencës lëndore, afatin e dorëzimit të vendimeve gjyqësore të arsyetuara, bashkimin e ankimeve në një gjykim të vetëm dhe afatin e shqyrtimit të tyre, Kolegji konstaton se ato janë me natyrë ligjore dhe si të tilla nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

34. Në lidhje me cenimin e së drejtës për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj, kërkuesi ka pretenduar se gjykata e apelit ka vepruar në kundërshtim me nenin 14 të KPP-së, ndërsa ka shqyrtuar çështjen me trup gjykues të formuar nga një gjyqtar. Kolegji konstaton se për këtë pretendim të ngritur edhe në rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është shprehur se është i pabazuar në ligj, duke vënë në dukje ndryshimin që ka pësuar pika 4 e nenit 14 të KPP-së me ligjin nr. 41/2021 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995, “Kodi

i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”. Në fakt, neni 14 i KPP-së, që rregullon përbërjen e gjykatës së apelit, në pikën 4 të ndryshuar të tij, që ka qenë në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes në rastin konkret nga gjykata e apelit, parashikon se gjykimet për kërkesat e parashikuara në pikën 2 të nenit 13 të këtij kodi shqyrtohen nga një gjyqtar i vetëm, ndërkohë që në këtë të fundit, krahas një liste konkrete kërkesash, parashikohet edhe çdo kërkesë tjetër e parashikuar në këtë kod (shkronja “f”). Nisur nga kjo, Kolegji vëren se gjykimi nga gjykata e apelit me gjyqtar të vetëm i ankimeve të kërkuarit ndaj vendimeve të gjykatës së shkallës së parë për kërkesat e tij për shuarjen e masës së sigurimit, është bërë sipas përcaktimit të ligjit. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuari nuk ka arritur të argumentojë në nivel kushtetues cenimin e së drejtës për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

35. Kolegji vëren se pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, në thelb, kanë të bëjnë me mënyrën se si gjykatat e faktit kanë interpretuar dispozitat procedurale penale në lidhje me kohëzgjatjen e paraburgimit dhe, më tej, për mënyrën se si Gjykata e Lartë ka vlerësuar zbatimin nga ato të ligjit dhe përgjigjen që ajo u ka dhënë shkaqeve në rekursin e tij. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se këto pretendime do të analizohen në vijim të ndërlidhura me njëra-tjetrën.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

36. Kërkuari ka pretenduar se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar keq ligjin kur arsyeton se masat e sigurimit për të cilat është kërkuar shuarja janë caktuar më vonë dhe efektet e tyre kanë filluar kur kanë mbaruar efektet e masës së parë, duke iu referuar për këtë vendimit nr. 00-2023-435, datë 13.03.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili nuk është vendim njësuës dhe, për më tepër, kur rasti i tij është i ndryshëm, ndërkohë që gjykata e apelit nuk i ka dhënë përgjigje këtij pretendimi. Po sipas tij, gjykatat kanë zbatuar keq ligjin, ndërsa nuk kanë marrë parasysh se masat e sigurimit për të cilat është kërkuar shuarja, në përmbushje të nenit 250 të KPP-së, i janë komunikuar në datën 22.02.2022, ditë nga e cila sipas kësaj dispozite kanë filluar dhe efektet e tyre. Për rrjedhojë, sipas kërkuarit, paraburgimi ka humbur fuqinë qoftë në kuptim të nenit 264, paragrafi 3, të KPP-së, ashtu edhe të nenit 263, paragrafi 1, shkronja “b”, të këtij kodi. Gjithashtu, sipas kërkuarit, gjykata e apelit ka gabuar kur ka bashkuar ankimet e tij në një gjykim të vetëm, megjithëse ato lidheshin me kërkesa që mbështeteshin në dispozita të ndryshme ligjore, ndaj për

shkak të këtij bashkimi, ai nuk ka marrë përgjigje për pretendimet e ngritura në secilin ankim. Ndërsa Gjykata e Lartë, pretendon kërkuesi, nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekursin e tij, megjithëse në të janë parashtruar çështje që kishin nevojë për njësim të praktikës gjyqësore në lidhje me momentin kur fillon efektet masa e arrestit në burg në rastin kur personi ka qenë nën efektet e një mase të mëparshme.

37. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se nëse mohohet e drejta e aksesit, procesi konsiderohet i parregullt, sepse ajo, para së gjithash, është kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 16, datë 23.03.2023; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Gjithashtu, sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 9, datë 23.02.2023; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 1, datë 19.01.2018; nr.25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, Gjykata është shprehur se në rast se Kolegji i asaj gjykate në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Kjo është edhe përgjigjja që u jep Gjykata e Lartë pretendimeve të ngritura në rekurs nga palët (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 59, datë 23.07.2015; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Po ashtu, Gjykata në mënyrë konstante ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Bazuar në standardet kushtetuese të mësipërme, Kolegji do të verifikojë nëse janë ose jo haptazi të pabazuara, referuar materialeve të çështjes, pretendimet e kërkuesit se nuk ka marrë përgjigje nga gjykatat e zakonshme për pretendimet e tij në kërkesë, në ankim dhe në rekurs, se arsyetimi i vendimeve të gjykatave të zakonshme është i pamjaftueshëm dhe se interpretimi nga ato i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës.

41. Duke iu kthyer rastit konkret Kolegji konstaton se gjykata e shkallës së parë është vënë në lëvizje nga kërkuesi përmes katër kërkesave për shuarjen e masave të sigurimit “Arresti në burg”, të caktuara ndaj tij në kuadër të dy procedimeve penale, të cilat më pas janë bashkuar në një të vetëm, ndërsa prokurori i ka kërkuar gjykatës (gjyqtarit të seancës paraprake) dërgimin në gjyq të çështjes për një nga akuzat në ngarkim të kërkuesit (atë për veprën penale “Përndjekja”, të parashikuar nga neni 121/a i KP-së, dy herë), si dhe pushimin e hetimeve për një nga veprat penale të dyshuara (“Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, të parashikuar nga neni 109/b, paragrafi 1, i KP-së). Gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar secilën nga kërkesat e kërkuesit, duke i rrëzuar ato.

42. Në lidhje me kërkesën e parë të kërkuesit, gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se paraburgimi ndaj kërkuesit nuk ka humbur fuqinë sipas nenit 264, paragrafi 3, të KPP-së, pasi nuk rezulton që kohëzgjatja e tij të jetë më e madhe se gjysma e maksimales së dënimit të parashikuar për veprën penale për të cilën ai është proceduar, në rrethanat kur: (i) kërkuesi është proceduar për dy vepra penale, atë sipas nenit 121/a të KP-së që parashikon si dënim burgimin nga gjashtë muaj deri në katër vjet dhe atë sipas nenit 109/b të KP-së, që parashikon si dënim burgimin nga dy vjet deri në tetë vjet, ku referuar të parës gjysma e maksimales së dënimit është dy vjet, ndërsa referuar të dytës ajo është katër vjet; (ii) kërkuesi ndodhet në paraburgim prej datës 22.07.2021 në kuadër të një mase sigurimi të caktuar në një

procedim tjetër penal, ndërkohë që masat e sigurimit për të cilat është kërkuar shuarja janë caktuar më vonë, ndaj efektet e tyre fillojnë pas mbarimit të efekteve të masës së parë; (iii) edhe sikur të pranohet se masat e sigurimit për të cilat është kërkuar shuarja i kanë prodhuar efektet që në momentin e caktimit të tyre (datë 26.01.2022), përsëri nuk është plotësuar gjysma e maksimales së dënimit për një nga veprat penale për të cilën ai është proceduar (atë sipas nenit 109/b të KP-së).

43. Në lidhje me kërkesën e dytë të kërkuesit, gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se paraburgimi ndaj kërkuesit nuk ka humbur fuqinë sipas nenit 263, paragrafi 1, shkronja “b”, të KPP-së, pasi nuk rezulton që nga fillimi i zbatimit të masave për të cilat është kërkuar shuarja të kenë kaluar gjashtë muaj pa u dorëzuar aktet në gjykatë, në rrethanat kur masat e sigurimit për të cilat është kërkuar shuarja kanë filluar efektet e tyre pas datës 23.09.2023, ditë kur Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (me vendimin nr. 1784) ka vendosur shuarjen e masës së sigurimit “Arrestin në burg” të caktuar më parë ndaj kërkuesit në kuadër të një procedimi tjetër penal dhe se referuar kësaj date, duke pasur parasysh se aktet tashmë janë dorëzuar në gjykatë, rezulton të mos ketë kaluar afati gjashtëmuajor i përcaktuar në atë dispozitë ligjore. Lidhur me përfundimin për fillimin e efekteve të masave të sigurimit në rastin konkret, ajo gjykatë i është referuar vendimit nr. 00-2023-435, datë 13.03.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili vetë i është referuar një vendimi të mëparshëm të tij (vendimit nr. 00-2022-205, datë 10.02.2022), ku është mbajtur qëndrimi se në rastin kur ndaj personit, i cili ndodhet nën një masë sigurimi personal “Arrestin në burg”, vendoset një masë e re sigurimi “Arrestin në burg”, kjo e fundit duhet t’i njoftohet personit ndaj të cilit është vendosur masa e re e sigurimit personal, në momentin kur mbarojnë efektet e masës së parë të sigurimit personal, që është dhe momenti kur fillojnë efektet e masës së re, në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 57 të KP-së dhe nenit 250 të KPP-së.

44. Në lidhje me kërkesën e tretë të kërkuesit, gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar paraburgimi ndaj kërkuesit nuk ka humbur fuqinë sipas nenit 263, paragrafi 1, shkronja “b”, të KPP-së, pasi nuk rezulton që nga fillimi i zbatimit të masave për të cilat është kërkuar shuarja të kenë kaluar gjashtë muaj pa u dorëzuar aktet në gjykatë, duke vërejtur se jemi para një kërkesë të përsëritur dhe për të cilën ajo ishte shprehur më parë.

45. Në lidhje me kërkesën e katërt të kërkuesit, gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se paraburgimi ndaj kërkuesit nuk ka humbur fuqinë sipas nenit 263,

paragrafi 1, shkronja “b”, të KPP-së, pasi nuk rezulton që nga fillimi i zbatimit të masave për të cilat është kërkuar shuarja të kenë kaluar gjashtë muaj pa u dorëzuar aktet në gjykatë, duke vërejtur sërish se jemi para një kërkesë të përsëritur dhe për të cilën ajo ishte shprehur më parë.

46. Kolegji vëren se kërkuesi i ka kundërshtuar të katërta vendimet e gjykatës së shkallës së parë, ndërsa gjykata e apelit ka vendosur bashkimin e ankimeve të tij dhe shqyrtimin e tyre në një gjykim të vetëm, duke vendosur në përfundim të tij lënien në fuqi të vendimeve të gjykatës së shkallës së parë. Sipas gjykatës së apelit, qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë, pasi në rastin konkret jemi në kushtet kur ndaj kërkuetit janë caktuar disa masa sigurimi “Arresti në burg”, ku masa e parë është dhënë në një procedim tjetër penal, ndaj masat e mëvonshme i fillojnë efektet pas mbarimit të efekteve të masës së parë. Sipas saj, kjo situatë rregullohet nga neni 250 i KPP-së, normë e cila është interpretuar në këtë mënyrë edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij nr. 00-2022-205, datë 10.02.2022. Po sipas saj, një përfundim i tillë arrihet edhe nga interpretimi i nenit 22 të ligjit nr. 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Nëse pranohet pretendimi i kërkuetit se efektet e masave të sigurimit “Arresti në burg” ecin paralelisht, sipas asaj gjykate, do të rezultonte që në rastin e dënimit të tij e njëjta periudhë paraburgimi do të llogaritej njëkohësisht për efekt të vuajtjes të disa dënimeve penale edhe pse nuk ka vendim gjyqësor për bashkimin e tyre. Për rrjedhojë, sipas gjykatës së apelit, paraburgimi ndaj kërkuetit nuk ka humbur fuqinë qoftë sipas nenit 263, paragrafi 1, shkronja “b”, të KPP-së, ashtu dhe sipas nenit 264, paragrafi 3, të këtij kodi.

47. Kolegji vëren se për rekursin e kërkuetit Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, duke arsyetuar se ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 289, pika 8, të lidhur me nenin 432 të KPP-së. Sipas asaj gjykate, kërkuesi ka ripërsëritur në rekurs të njëjtat pretendime për të cilat ka marrë përgjigje shteruese nga gjykata e apelit, vendimi i së cilës është i drejtë dhe i argumentuar ligjërisht, ndërsa ajo me të drejtë i është referuar nenit 250 të KPP-së, duke e interpretuar saktë atë në raport me situatën faktike në rastin konkret. Po sipas saj, nuk konstatohet mosrespektim apo zbatim i gabuar të ligjit penal nga gjykata e apelit me rëndësi për njesimin e praktikës gjyqësore, nuk konstatohen shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit të rekursuar, të akteve apo të provave, si dhe nuk rezulton që vendimi i gjykatës së apelit të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal apo të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

48. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se duke iu referuar në tërësi pretendimeve të kërkuarit, fakteve në rastin konkret dhe standardeve kushtetuese, rezulton se ai ka marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat e zakonshme në lidhje me pretendimet e ngritura në kërkesë, në ankim dhe rekurs. Vendimet e gjykatave të faktit pasqyrojnë mjaftueshëm faktet dhe ligjin e zbatueshëm për sa i përket kohëzgjatjes së paraburgimit dhe humbjes së fuqisë së tij, sikundër edhe argumentet e gjykatave në lidhje me qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Po ashtu, Gjykata e Lartë, në rolin e saj si gjykatë e ligjit, i ka dhënë përgjigje kërkuarit në lidhje me mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit procedural, të aplikueshëm në rastin e tij. Në këndvështrim të standardit të arsytimit, Gjykata e Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e rekursit të paraqitur nga kërkuari, ka arsyetuar se përse nuk bëjnë pjesë në ato të parashikuara nga neni 289, pika 8, i lidhur me nenin 432 të KPP-së, duke vlerësuar të drejtë vendimmarrjen dhe arsytimin e gjykatës së apelit. Mospranimi i rekursit të kërkuarit nga ana e atij kolegji të Gjykatës së Lartë, në kuadër të shqyrtimit paraprak të tij, është në përputhje me kompetencat e njohura nga ligji procedural, ndërsa është në vlerësimin e atij kolegji për të vendosur nëse çështja duhet të shqyrtohet në seancë dhe, për më tepër, për të njësuar praktikën gjyqësore. Në procesin gjyqësor të kundërshtuar nga kërkuari nuk konstatohen shkelje të të drejtave kushtetuese dhe as që zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme të ketë qenë arbitrar, pra që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë sipas nenit 42 të Kushtetutës. Vetëm fakti se në përfundim të procesit gjyqësor kërkesat e kërkuarit nuk janë pranuar, nuk vë në dyshim të drejtën e tij për proces të rregullt.

49. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor nuk gjen mbështetje në materialet e çështjes, ndaj ky pretendim është haptazi i pabazuar.

50. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.